



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3027/ 12 prot.

Datë 16/12/2024

V E N D I M

Nr. 1781/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16/12/2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1598/2024, datë 13.11.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-17214-08-27-2024, me objekt “Rikonstruksion i shkarkuesit katastrofik te rezervuarit Malaj 1, Bashkia Mirdite”, me fond limit 10.000.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.09.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

Ankimues: Operatori ekonomik “AEK Munella” SHPK, me NIPT: J98926001P dhe me adresë: Lagjja “Gjakez”, Ndërtesë me nr. pasurie 40, Zona kadastrale 1717, Fan, Mirdit, Lezhë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Mirditë
Adresa: Sheshi “Abat Doci”, Rrëshen.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 13.11.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1598/2024, datë 13.11.2024, ku vendosi:

[...]

1. *Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini I SHPK & AEK MUNELLA SHPK”, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-17214-08-27-2024, me objekt “Rikonstruksion i shkarkuesit katastrofik te rezervuarit Malaj I, Bashkia Mirdite”, me fond limit 10.000.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.09.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini I SHPK & AEK MUNELLA SHPK”, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AEK MUNELLA” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 4493/1 prot., datë 02.12.2024, protokolluar me tonën nr. 3027/9 prot datë 03.12.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1598/2024, datë 13.11.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “Drini I SHPK & AEK MUNELLA SHPK” në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-17214-08-27-2024, me objekt “Rikonstruksion i shkarkuesit katastrofik te rezervuarit Malaj I, Bashkia Mirdite”, me

fond limit 10.000.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.09.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 4493/1 prot., datë 02.12.2024, protokolluar me tonën nr. 3027/9 prot datë 03.12.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1598/2024, datë 13.11.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “*Drini 1 SHPK & AEK MUNELLA SHPK*” në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-17214-08-27-2024, me objekt “*Rikonstruksion i shkarkuesit katastrofik te rezervuarit Malaj 1, Bashkia Mirdite*”, me fond limit 10.000.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.09.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit, duke kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “*Drini 1 SHPK & AEK MUNELLA SHPK*” në procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 1598/2024, datë 13.11.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-17214-08-27-2024, me objekt “*Rikonstruksion i shkarkuesit katastrofik te rezervuarit Malaj 1, Bashkia Mirdite*”, me fond limit 10.000.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.09.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

